

# Raport i v.2010 i Analizave të Përqendruara tek Mendimet e Qytetarëve Marrëdhëniet ndëretnike




Shumica e të anketuarve (58%) nuk kanë parë ndryshim në gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike në vend gjatë 12 muajve përpara sondazhit, ndërsa një e dhjeta (11%) mendojnë se ato janë përmirësuar.

Shoqëria e Maqedonisë mund të përshkruhet si demokraci e re shumëetnike në të njëjtën kohë, shumëkombëshe, plurale dhe multikulturale. Një pasqyrë e shkurtër e strukturës së përkatësisë etnike shoqëruar me gjetjet e sondazhit është paraqitur në kapitullin mbi marrëdhëniet ndëretnike. Sipas gjetjeve në Raport, çështjet kyçe janë problemet ekonomike dhe pasojat diskriminuese të sistemit ekonomik si dhe zgjerimi i të ashtuquajturit hendek i frustrimit. Një tjetër aspekt shqetësues ka të bëjë me redistribuimin e burimeve publike dhe pushtetit politik përmes përfaqësimit të drejtë, decentralizimit dhe politikave të tjera jodiskriminuese. Ky Kapitull poashtu përqendrohet tek roli i partive dhe drejtuesve politikë si dhe tek perceptimi i marrëdhënieve ndëretnike në vend.

Përfaqësimi i drejtë është një instrument i rëndësishëm i përfshirjes politike dhe sociale të pakicave në shoqëri. Gjatë këtyre viteve të fundit ka pasur një rritje të përfaqësimit të drejtë në administratë, ushtri, polici dhe në gjyqësor, edhe pse kuota ende nuk është arritur. Sipas të dhënave të fundit mbi përbërjen etnike, 22% e përfaqësuesve të ushtrisë profesionale janë shqiptarë etnik, 2,3% janë turq, 1,3% janë romë dhe 2,4% janë serbë. Nga ana tjetër, "partizimi" i administratës shtetërore vlerësohet si një dobësi aktuale që po vazhdon. Sipas deklaratës së një anëtari të Gjykatës Evropiane të Auditorëve, vështirësitë me të cilat ballafaqohen projektet evropiane për përforcimin institucional, mes tjerash, kanë të bëjnë me "administratën jostabile", dmth, ndryshimet partiake në administratë, pas çdo zgjedhjeve.

Pritjet për ndryshim në marrëdhëniet ndëretnike në gjashtë muajt që pasojnë



Gjysma e të anketuarve shpesh shkojnë nëpër restorante ose kafene që janë pronë e personave nga një grup tjetër etnik

Shumica e njerëzve i shikojnë tensionet ndëretnike si më pak të rrezikshme se tensionet midis të pasurve dhe të varfërve dhe midis punonjësve dhe menaxherëve. Shumica gjithashtu konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike nuk u përkeqësuan në v. 2009 dhe nuk presin që të përkeqësohen as në të ardhmen. Të pyetur nëse presin një konflikt të dhunshëm etnik, shumica është përgjigjur se nuk ekziston një rrezik i tillë apo se është shumë i ulët.



• Për ta bërë shoqërinë më të qëndrueshme, kohezive dhe përfshirëse, për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike dhe për të ulur nivelin e paragjykimeve, jotolerancën dhe diskriminimit, Raporti vë në spikamë një strategji me dy pista:

• Përpjekjet afatgjata të politikave qeveritare, synojnë uljen e kushteve themelore që shkaktojnë më tepër konflikte ndëretnike - niveli i lartë i papunësisë, varfërisë, pabarazisë dhe diskriminimit, veçanërisht kundër popullsisë rome.

• Politikbërësit dhe aktivistë të shoqërisë civile duhet të afirmojnë efektet stabilizuese të zbatimit të MKO për të krijuar një shoqëri më tolerante multi-etnike.

• Partitë dhe drejtuesit politikë janë elementë udhërrëfyes për rritjen e ambientit të tolerancës dhe për promovimin e shoqërisë shumë-etnike. Politikat qeveritare si dhe OJQ-të duhet të përqendrohen në përmirësimin e cilësisë së arsimit publik dhe privat, sepse arsimi shikohet nga shumica e njerëzve si një faktor i kohezionit etnik më shumë se çdo institucion tjetër shoqëror përveç familjes. Institucionet shtetërore duhet të zhvillojnë dhe të mbështesin projektet e mësimin dhe aktivitete të përbashkëta. Një nga rekomandimet që del nga ky publikim është promovimi i projekteve që do të forcojnë kontaktet në mes nxënësve nga nacionalitete të ndryshme.

Rreth serive të Raportit të Analizave të Përqëndruara tek Mendimet e Qytetarëve: Raporti i v. 2010 i Analizave të Përqëndruara tek Mendimet e Qytetarëve vazhdon të ekzaminojë trendet dhe aspektet e përfshirjes sociale siç është bërë që nga botimi i tij i parë në mars 2008, ku fokusi kryesor i Raportit ishte përfshirja sociale e ekzaminuar përmes thjerrëzave të dimensioneve Qeverisëse dhe Etnike.

Kjo seri raportesh vazhdoi me botimin e dytë në prill 2009, ku fokusi kryesor vihej tek zhvillimi Rajonal dhe Cilësia e jetës. Secili raport mbështetej tek gjetjet e sondazhit me 1,000 të anketuar (3000 të anketuar për raportin e dytë Rajonal) në gjithë vendin me mbështetje financiare nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Këto raporte synojnë krijimin e hapsirës për hulumtime profesionale, të paanshme, të balancuara, pragmatike dhe konstruktive të politikave dhe të kapaciteteve në vend, me vlerësime mbi rritjen e përfshirjes dhe politikbërjen e bazuar mbi evidencën, cilësinë e qeverisjes dhe përfundimisht mbi jetët e njerëzve.

**RRETH KONCEPTIT TË PËRFSHIRJES SOCIALE:** Përfshirja sociale përcakton vlerat e një shoqërie me anë të njohjes së “detyrës për t’u kujdesur” të qeverisë për të siguruar të gjitha mjetet e nevojshme për çdo person që të jetë pjesë e shoqërisë moderne me mundësi të barabarta sociale, ekonomike dhe/ose politike. Ajo poashtu adreson të gjitha format e pabarazisë brenda-shtetit. Përfshirja sociale është përgjigje ndaj mangësive institucionale, që është një proces afatgjatë i cili kërkon ndryshime në qëndrimet sociale dhe raportet e pushtetit. Ajo poashtu ka një anim operacional, që planifikon përgjigjet e politikave të realizueshme, duke njohur në mënyrë efektive se Shteti ka ‘detyrë për t’u kujdesur’ për të përfshirë të gjithë pjesëtarët e shoqërisë në proceset politike, ekonomike dhe sociale. Aq më tepër, përfshirja sociale duhet t’u përgjigjet diskriminimeve të ndryshme si gjinia, moshë, etniciteti ose paaftësia, etj.

**RRETH UEJL-së:** Universiteti i Evropës Juglindore është institucion i arsimit të lartë në vitin e tetë të veprimtarisë së vetë. Nga hapja e kampusit në Tetovë në tetor 2001, ai ka arritur të ngritet në një universitet të drejtuar nga cilësia dhe financiarishti i qëndrueshëm. Ai shikohet tash si model i arsimit të lartë shumë-etnik, shumë-gjuhësor në Evropën Juglindore. Ka arritur të bëjë kombinimin e përvojës më të mirë evropiane dhe amerikane dhe ka vazhduar të përfitojë nga bashkëpunimi akademik i sponsorizuar nga Komisioni i BE-së dhe USAID-i, krahas donatorëve të tjerë. UEJL arrin tek institucionet tjera duke promovuar bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve, shkëmbimin e studentëve dhe stafit dhe në komunitetin e tij. [www.seeu.edu.mk](http://www.seeu.edu.mk)